



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1304 Prot

Lezhë, më 1 / 2 /2023

VENDIM

Nr 4 , datë 31 / 01 /2023

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIMIN E QIRASË  
PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 për “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë dhe tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM Nr. 459, datë 03.07.2019 për “ Rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin. Vendimin e Këshillit Bashkiak Lezhë nr.181, datë 23.12.2021 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit dhe programeve sociale të strehimit”, Relacionin e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social nr. 476 prot., datë 16.01.2023, “Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Lezhë nr. 476/1 prot., datë 16.01.2023 “Për miratimin e listës së familjeve përfituese për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2023”, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të miratoje listën e familjeve që përfitojnë subvencionim e qirasë për vitin 2023 me numër rendor 63, sipas tabelës nr.3 bashkëlidhur dhe pjesë e pandashme e këtij vendimi.
2. Në zbatim të këtij vendimi, Bashkia Lezhë t’i paraqesë kërkesën Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për financimin e subvencionit të qirasë nga buxheti i shtetit, me afat kohor 1 vjeçar.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

K.B.

Nr. 1304/ prot  
Dt. 04.02.2023

Nr. 103/7 Prot.

Lezhë, më 06.02.2023

**Lënda: Konfirmim vendimi**

### KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", nenin 9 dhe nenin 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr 22/2018 "Për strehimin social", VKM-së nr. 384, datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore" VKM-në nr 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM-në nr.459, datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" konfirmoj bazueshmërinë ligjore të Vendimit nr.4, datë 31.01.2023 të Këshillit të Bashkisë Lezhë, "Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e qirasë për vitin 2023".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

